

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA E NOTERISË DURRËS**

Nr 348 Rep. 185 Kol.



**AKT THEMELIMI**

**I SHOQERISE “EVS - 2017” Shoqeri me Pergjegjsi te Kufizuar (SH.P.K.)**

Sot, me datë 17-02-2017, ditën e premte, para meje Noter Alban S.Gjoci, anëtar i dhomës së noterisë Durrës, me seli në lagjen № 4 të Kavajës, u paraqit personalisht shtetasi shqiptar:

**THEMELUESI (ORTAKU VETEM), ELTON SARAÇI**, i biri i Vahidit, e dtl; 27.02.1990, lindur ne Gose e banuese në Gosë të bashkisë Rrogozhinë, i paisur me Leternjoftim ID № 033294912 e numër personal J00227053C, qe ne vijim do te quhet **“ORTAKU”**

i cili më kerkoj redaktimin e këtij Akti Themelimi, duke shprehur vullnetin e lire te tij, mbeshtetur ne ligjin 9901, date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare”, me ndryshimet e mëvonëshme, qe vendos te themeloje Shoqerine me Pergjegjsi te Kufizuar, sipas kushteve vijuese:

**KREU I**

**OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**

**Neni 1. Objekti i shoqerisë:**

**1.1** Shoqeria ka si objekt te aktivitetit te saj: Punime gërmimi në tokë. Ndërtime civile dhe industriale. Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada. Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Punime nëntokësore, ura e vepra arti. Diga dhe tunele hidroteknike. Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje. Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë. Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime. Ndërtimi i impiantevë për prodhimin e energjisë elektrike. Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. Punime të inxhinierisë së mjedisit. Punime për prishjen e ndërtimeve. Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanderi, mirëmbajtja e tyre. Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues). Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese. Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut. Barriera dhe mbrojtje rrugore. Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri. Punime strukturorë speciale. Shtresa dhe mbistruktura speciale. Punime mbi shina dhe traversa. Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit. Impiante dhe linja telefonie dhe



telekomunikacioni. Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj. Pastrimi i ujërave detarë, liqenor dhe lumor. Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij. Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane. Punime topogjeodezike. Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë. Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë. Gërmime të kategorive e llojeve të ndryshme ; Përpunim dhe montim dekore në Polisterol, Gips dhe Beton ; Import Eksport te artikujve (mallrave) te ndryshem, industriale, bujqesore e blegtorale; Shitje me shumice e pakice te artikujve te ndryshem, industriale, bujqesore e blegtorale, lendeve te ndertimit, pjese këmbimi te makinerive te ndryshme e automjeteve si dhe çdo mall tjetër te lejuar per qarkullim nga legjislacioni shqiptar.

## **Neni 2. Emertimi, Selia Juridike e Shoqerise.**

- 2.1. Ortaku i vetem ka vendosur qe shoqerine ta emertoje: “ **EVS - 2017**”
- 2.2. Selia Juridike e Shoqerise ndodhet ne Gosë Qendër të njësisë administrative Gosë të bashkisë Rrogozhinë.
- 2.3. Shoqeria mund te krijojë Qendra Dytesore, Filiale, Zyra Perfaqsimi, Agjensi , ne qytete te tjere te shqiperise si dhe jashte territorit te shqiperise.

## **Neni 3. Regjimi Juridik.**

- 3.1. Shoqeria eshte SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR. Aktiviteti i saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit te Shoqerise dhe Legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 3.2. Me Vendim te Ortakut te Shoqerise, Ortaku i Vetem mund te ndryshojë Regjimin Juridik te Shoqerise, nese ne te ardhmen krijohen premisa te favorshme per funksionimin e saj, sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaku duhet të përshtasë Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise dhe te beje regjistrimin e ndryshimeve ne Regjistrin Tregtar, prane organit kompetent shqiptar
- 3.3. Shoqeria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit(QKR), ose Qendra Kombëtare e Biznesit(QKB) ne perputhje me ligjin
- 3.4. Shoqeria do te kete vulen e saj e cila do te permbaje dhe emer in e shoqerise “ **EVS - 2017**” Sh.P.K.

## **KREU II**

### **TE DREJTAT E DETYRIMET, AFATI**

#### **Neni 4. Te drejtat e Shoqerise dhe Ortakut.**

- 4.1. Shoqeria gezon te drejten te lidhe marreveshje e te lidhe kontrata te ndryshme, ne territorin e shqiperise dhe jashte saj.
- 4.2. Shoqeria gezon te drejten te zhvilloje(krijojë) pronesi materiale dhe intelektuale.
- 4.3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese, si Ortak, ne Shoqeri apo Ndermarrje te tjera, brenda ose jashte territorit te shqiperise, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.



- 4.4. Shoqëria mban përgjegjësi ndaj të tremeve, vetëm dhe ekskluzivisht, me kapitalin e saj të derdhur dhe të mirat materiale nga pasuria e saj.
- 4.5. Ortaku ka të drejtë të marrë të gjitha informacionet në raport me aktivitetin prodhues, projektues, të realizimeve tregtare të shoqërisë, si bilanci, llogaritë ekonomike, etj.
- 4.6. Ortaku ka të drejtë të emerojë apo shkarkojë, Administratorin ose Administratorët, Punonjës të shoqërisë, Ekspert kontabel, Likuidator.

#### **Neni 5. Afati (Kohezgjatja)**

- 5.1. Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një afat të pacaktuar.

### **KREU III**

#### **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**

##### **Neni 6**

- 6.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është në shumën 100.000 leke, dhe kapitali aktualisht është i ndarë vetëm në një kuotë.
- 6.2. Këto kuota janë në masën 100 % të Ortakut të Vetëm, **Elton Saraçi**.
- 6.3. Kapitali do të derdhet në para CASH në Bankë.

### **KREU IV**

#### **ORGANET e SHOQËRISE**

##### **Neni 7**

- 7.1. Vendimet e Shoqërisë merren nga Ortaku i vetëm i Shoqërisë, në Asamblenë e Përgjithshme.

Administratori i Shoqërisë dhe eventualisht Eksperti Kontabel i Autorizuar do të caktohet e ngarkohet nga Ortaku i Shoqërisë.

### **KREU V**

#### **ADMINISTRIMI**

##### **Neni 8**

- 8.1. Administrimi i Shoqërisë do të bëhet nga Administratori i saj, i cili është Ortaku i Vetëm z. **ELTON SARAÇI**.
- 8.2. Eksperti Kontabel i shoqërisë është z. Xhevdet Islami.
- 8.3. Kohëzgjatja në detyrë e Administratorit të shoqërisë do të jetë 5 vjet, ndërsa e Ekspertit kontabel është një vit, nga data e regjistrimit të shoqërisë.

### **KREU VI**

#### **DISPOSIZITA TE TJERA**

##### **Neni 9**

- 9.1. Fitimi i realizuar i Shoqërisë, pas likuidimit të detyrimeve ligjore, do të mbetet Ortakut të Vetëm të Shoqërisë, i cili aktualisht zëton 100 % e kuotave të Shoqërisë, me



detyrimin qe nga fitimi i realizuar, Shoqeria do te rezervoje nje pjese prej 1/20 te tij dhe me arrijten e shifres prej 1/10 se kapitalit te shoqerise, nga rezervat vjetore, atehere keta rezerva kalojne perfundimisht ne pronesi te Ortakut te Vetem.

- 9.2. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Akt Themelimi, per çdo paqartesi apo mosmarrveshje, vlejne dispozitat e ligjit 9901, date 14.04.2008 me ndryshimet e mëvonëshme " Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare".
- 9.3. Ky Akt perpilohet e nenshkruhet ne kater kopje te me vlere te njejte ligjore. Nje kopje do te qendroje ne dokumentacionin baze te Shoqerise.

---

Per sa me sipër, mbeshtetur ne nenet 79 e vijues te K.Civil, ne ligjet 7829, date 01.6.1994 dhe 9901, date 14.04.2008, me ndryshimet e modifikimet e tyre të mëvonëshme, une Noteri e vertetoj këte akt sipas ligjit ne fuqi.

### ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

Elton Saraçi

**NOTER**  
Alban S. Gjoci